

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Isa Shla dhe Qerim Ademaj, anëtarë në çështjen juridike të paditësit Gazeta e përditshme “Tribuna Shqiptare” sh.p.k me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim avokati N.P., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, të cilën e përfaqëson me autorizim H.K., për shkak të pagesës të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Ekonomike, III.C.nr.21/2014,të datës 30.04.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 20.05.2017, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Prishtinës, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Ekonomike, III.C.nr.21/2014,të datës 30.04.2015, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar nën paragrafin I. të dispozitivit, e ka shfuqizuar aktvendimin për lejimin e përmbarimit E.nr.1017/13 të dt.17.09.2013, ashtu qe ky Aktvendim, në pjesën obliguese për borxhin kryesor, kamatën dhe shpenzimet, suprimohet në tërësi. Në paragrafin II të dispozitivit ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit Gazeta e përditshme “Tribuna Shqiptare” sh.p.k me seli në Prishtinë dhe ka detyruar të paditurën Komuna e Prishtinës, që paditësit t’ia paguajë borxhin kryesor në shumën e përgjithshme prej 464,00 €, me kamatë vjetore prej 8% duke filluar nga 16.09.2013 deri në pagesën definitive, të gjitha në afatin kohor prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me detyrim. Në paragrafin III të dispozitivit ka detyruar të paditurën Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, që paditësit Gazeta e përditshme “Tribuna Shqiptare” sh.p.k me seli në Prishtinë, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguajë shumën prej 307.05 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga data e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, Komuna e Prishtinës, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta aprovojë si të bazuar ankesën e të paditurës dhe aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe këtë çështje ta kthejë në rigjykim ose ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësi Gazeta e përditshme “ Tribuna Shqiptare” me datë 16.09.2013, ka parashtruar pranë kësaj gjykate propozimin për përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm (faturave) në shumën prej 464.00 €, njëherit ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Gjykata e shkallës së parë me dt.17.09.2013, ka marrë aktvendim për lejimin e përmbarimit sipas propozimit të kreditorit Gazeta e përditshme “Tribuna Shqiptare” sh.p.k me seli në Prishtinë. Kundër aktvendimit për përmbarim E.nr.1017/13 të dt.17.09.2013, e paditura në afatin ligjor ka paraqitur kundërshtimin, duke e kontestuar aktvendimin për përmbarim në tërësi. Në bazë të ushtrimit të kundërshtimit, aktvendimi për përmbarim është shfuqizuar në pjesën detyrimore që ka të bëjë me borxhin kryesor dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe çështja konform nenit 58.4 të LPP-së (Ligji nr.03/1-008), ka kaluar në procedurë kontestimore, në të cilën propozimi për përmbarim ka marrë cilësinë e padisë.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat e lëndës, fatura me nr.047/12 e datës 31.01.2012, shkresat elektronike të dt.20.01.2012, ka gjetur se kërkesëpadia është e bazuar. Nga fatura u vërtetua se paditësja kishte bërë publikime në gazetën ditore “Tribuna Shqiptare” dhe për këtë pas publikimeve i kishte dërguar të paditurës faurat të cilat arrin shumën prek 464.00 €. Fatura të cilat ishin pranuar dhe nënshkruar nga e paditura, përmbajnë përshkrimet lidhur me publikimet, datën e publikimit, sasinë, çmimin për publikim si dhe shumën e përgjithshme për publikimet e përshkruara në atë faturë. Nga provat e administruara, rezulton se paditësi dhe e paditura kanë qenë në marrëdhënie të vazhdueshme afariste për ofrimin e shërbimeve të publikimit, e paditura duke pranuar dhe duke mos kontestuar faturat e pranuar, ka pranuar shërbimet e publikimit, sipas nenit 42 par.3 të LMD-së andaj edhe është krijuar raporti detyrimor. Nga faturat dhe publikimet në gazetë vërtetohet fakti se paditësja me publikimin në gazetë ka kryer obligimet ndaj të paditurës, duke ia dërguar faturat për shërbimet e kryera në shumën prej 464.00 €, ndërsa e paditura edhe për kundër faktit të publikimeve në gazetë dhe të kryerjes së shërbimeve tjera, nuk e ka përmbushur detyrimin ndaj paditëses sipas shërbimeve të kryera dhe faturave të pranuar. Andaj duke u bazuar në të lartëcekurat gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit Gazeta e përditshme “Tribuna Shqiptare” sh.p.k me seli në Prishtinë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë

është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 262 par.1 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar *“kreditore në marrëdhënien detyrimore është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, kurse debitori është i detyruar që ta përmbushë detyrimin në tërësi”* dhe 262 par.2 të LMD-së; *“Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonon me përmbushjen e tij, kreditore ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”*, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura me mospagimin e faturave i ka mbetur borxh paditësit, ka gjetur se ekziston obligimi i të paditurës të paguajë borxhin në shumën e gjykuar.

Gjykata e Apelit ka gjetur se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar nenin 277 të LMD, sepse e paditura ka rënë në vonesë për pagesën e borxhit, andaj e paditura është e obliguar që t'ia paguajë paditësit, shumën e gjykuar së bashku me normën e kamatës, në lartësi prej 8%, nga data e parashtrimit të propozimit për përmbarim.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,**  
**Ae.nr.17/2016,dt.20.06.2017**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
**Mahir Tutuli, d.v.**